

Mbështetje dhe Banesë pas Kërkesës suaj për Strehim dhe pasi gjithë Apelimet tuaja janë Refuzuar.

Nëse Home Office* nuk ka marrë ende një vendim mbi kërkesën tuaj për strehim ose nëse keni ndonjë apelim ende në proces juve mund t'ju takojë mbështetje prej NASS*. Ka të ngjarë që mbështetja juaj të ndryshojë nëse kërkesa juaj për strehim dhe apelimet tuaja refuzohen.

A janë refuzuar gjithë kërkesat e mia për strehim dhe apelimet e mia?

Nëse nuk jeni të sigurt apo nëse gjendja në vendin nga vini ka ndryshuar, ju duhet të gjeni sa më parë që të jetë e mundur një këshillim ligjor - kërkojini këshillë avokatit tuaj ose kërkojini të ngarkuarit me rastin tuaj një listë avokatësh.

Mbështetje pasi të jenë refuzuar gjithë kërkesat për strehim dhe apelimet

Mund të jetë e vështirë të gjeni banim apo mbështetje kur ju refuzohet kërkesa për strehim. Megjithatë, ekzistojnë disa mundësi:

1. Mbështetja nga Seksioni 95 - mbështetja që merrni gjatë kërkesës suaj për strehim

- Nëse keni fëmijë nën moshën 18 vjeçare të cilët jetojnë me ju para se të përfundojë mbështetja S95 e NASS*-it, kjo mbështetje zakonisht vazhdon deri sa fëmija juaj të mbushë 18 vjeç.
- Nëse nuk keni fëmijë mbështetja juaj S95 e NASS*-it do të përfundojë 21 ditë pas refuzimit përfundimtar të kërkesës për strehim. NASS* do t'ju njoftojë për këtë me anë të një letre.

2. Mbështetja nga seksioni 4 - banesë bazë dhe ushqim apo kuponë.

- Nëse ju lindin fëmijë pasi të ketë përfunduar mbështetja juaj S95 e NASS*-it ose nëse nuk mund të largoheni nga MB ose nëse keni aplikuar që vullnetarisht të ktheheni në vendin tuaj, mund t'ju takojë mbështetje nga Seksioni 4. **Ju lutem lexoni fletë palosjen e Refugee Action's* mbi mbështetjen e Section 4* për më shumë të dhëna.**

3. Mbështetje nga autoritetet vendore

- Nëse keni probleme të rënda shëndetësore fizike apo mendore, nëse jeni i sëmurë apo i moshuar, Local Authority* do t'ju japin banesë dhe mbështetje. Ata së pari do të vlerësojnë gjendjen tuaj - kjo quhet Community Care Assessment* dhe mund të zgjasë disa javë.

- Nëse keni fëmijë dhe nuk ju takon mbështetje S95 apo S4, Local Authority duhet të mbështesin fëmijët tuaj, por nga ana tjetër ata kanë të drejtë t'i refuzojnë mbështetjen cilitdo në familjen tuaj që i ka kaluar të 18-at.

Nëse nuk futeni në asnjë nga kategoritë e mësipërme mund të ketë organizata vendore që mund t'ju ndihmojnë të gjeni banesë, ushqim dhe veshje.

Nëse keni ndonjë pyetje ju lutemi pyesni një nga punonjësit që merren me këto raste

* Këto fjalë janë emra anglisht organizatash ose fjalë të tjera që nuk mund të përkthehen. Ju lutemi pyesni më parë një punonjës që tua shpjegojë se çfarë do të thonë.